



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 92 Akti

Nr. 86 Vendimi

Tiranë, më 17.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 14 dhjetor 2018, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alma S. Kolgjoka, me detyrë gjyqtare dhe kryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, përfaqësuar personalisht.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të

provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tri kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, znj. Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 03.07.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën po në këtë datë deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

Më datë 07.12.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

Më datë 07.12.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Më datë 11.12.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e saj, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 12.12.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftoj subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 14.12.2018, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

Më datë 14.12.2018, u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, shprehu qëndrimin e saj, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 14.12.2018 për të rifilluar më datë 17.12.2018 për shpalljen e vendimit.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Alma Kolgjoka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

I. RIVLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e detajuar nr. *** prot., datë 08.01.2018, lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Vlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kreu një hetim administrativ të thelluar, i cili u bazua në: a) verifikimin dhe shqyrtimin e të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të datës 26.01.2017, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të; b) krahasimin e deklaratave periodike të pasurive të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”; c) shqyrtimin e të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare bankare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI-t, organet e tjera shtetërore, likuiditetet - gjendje *cash*; ç) hetimet e kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, më datë 11.12.2018, të paraqitura pas njohjes me rezultatet e hetimit, pasi në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se i qëndronte shpjegimeve të dhëna pas njohjes me rezultatet e hetimit.

I. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË NGA KOMISIONI

Në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (*shtojca 2*) të datës 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (*të paluajtshme dhe të luajtshme*):

1. **Automjet**¹, me targa ***, në pronësi të bashkëshortit, blerë në Gjermani, në dhjetor të vitit 2014. Vlera 3.999 euro (zhdoganuar në vitin 2015).

Burimi i të ardhurave deklaruar nga subjekti: të ardhura nga paga e të dyve.

ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. Automjeti i deklaruar konfirmohet nga DPSHTRR, i shitur më datë 01.08.2017, pas dorëzimit të deklaratës “Vetting””.

Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrative

1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (referuar si “DPSHTRR”)², me shkresën me nr. *** prot., datë 15.05.2018, informoi Komisionin se shtetasi D.K. (b/shorti i subjektit), ka pasur në pronësi e tij, automjet me targa ***, nga data 29.04.2015 deri në datën 02.08.2017, të cilën e ka shitur sipas kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.08.2018.

1.2 Pas verifikimit të dokumentacionit ligjor mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur burime financiare për blerjen e automjetit dhe shpenzimet e kryera në vitin 2014.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni reflektuar si më poshtë:

Tabela nr. 1

	Përshkrimi	2014
1	PASURI	560.440
	Blerë, automjet, tip “Audi” ***	560.440
2	TË ARDHURA	2.135.369
	Të ardhura subjekti	1.433.576
	Të ardhura bashkëshorti	701.793
3	SHPENZIME	482.143
	Shpenzime jetese	482.143
	Shpenzime udhëtimi	0
4	LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	24.756
	“NBG”, Alma Kolgjoka	7576
	“Raiffeisen Bank”, Alma Kolgjoka	17.145
	“Raiffeisen Bank”, D.K.	35
	CASH	0
5	LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	500.000
	“NBG” Alma Kolgjoka	7.950
	“Raiffeisen Bank”, Alma Kolgjoka	92.453
	“Raiffeisen Bank”, D.K.	-60
	CASH	399.657

¹Subjekti i ka bashkëlidhur paraktikës:

- Certifikatë pronësie të automjetit me targa ***;
- Leje qarkullimi automjeti;
- Deklaratë doganore e automjetit, vlera e automjetit 3.999 euro + 120.663 lekë taksë doganore.

² Shih në dosje e subjektit shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 02.02.2018, drejtuar DPSHTRR-së, dhe i është kërkuar informacion mbi çdo automjet të regjistruar në emër të subjektit apo personit të lidhur me të.

1.3 Nga përllogaritjet e kryera, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur b/shorti kanë pasur burime të ligjshme financiare në vitin 2014 për blerjen e automjetit si dhe për shpenzimet e kryera.

- ✚ **Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, përputhet me dokumentacionin e administruar dhe subjekti ka burime të ligjshme për blerjen e saj.**

2. Shtëpi private³ në proces legalizimi, aplikuar për legalizim më datë 20.03.2005.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie sipas deklarimit të subjektit: nga kursimet e familjes së bashkëshortit të subjektit.

ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur “*Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ALUIZNI-t*”.

Nga hetimi administrativ i Komisionit për këtë pasuri, ka rezultuar se:

2.1 Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana, Veri⁴ me shkresën nr. *** prot., datë 28.02.2018, ka konfirmuar, se për këtë pasuri, rezultojnë si subjekt aplikues për legalizim shtetasit S. L. K. dhe D. S. K.

2.2 Sipas deklarimeve të subjektit, por dhe sipas formularit “Vetëdeklarim për legalizim”, të datës 20.03.2005, shtëpia private në proces legalizimi ishte ndërtuar nga i vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. S. K., në vitin 1995 dhe aplikimi për t’u legalizuar ishte bërë nga S. K. dhe D. K. (*vjehri dhe bashkëshorti i subjektit*).

2.3 Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se aplikuesit kanë deklaruar se sipërfaqja e zënë ishte 500 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 120 m². Aplikimi për legalizim ishte bërë nga shtetasi S. K. dhe D. K., më datë 20.03.2005.

2.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e legalizimit të banesës, të sjellë nga ALUIZNI, Komisioni, ka konstatuar se fotot e depozituar nga vetëdeklaruesi në momentin e aplikimit, tregojnë një shtëpi 2-katëshe me papafingo dhe oborr, në gjendje ndërtimi të përfunduar dhe në pamje nuk duket se ka pasur nevojë për ndërtime shtesë apo punime të tjera për përfundimin e godinës.

³Për këtë aset subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim nga ALUIZNI nr. ***prot., datë 15.12.2016, ku vërtetohet se personat S. L. K. dhe D. S. K., rezultojnë me të dhënat si më poshtë: Njësia Nr. ***, objekti *** kat, nr. *** prot., sip. gjurme 120 m², sip. parcele 500 m², data 20.03.2005.
- Formular vetëdeklarimi për legalizim, datë 20.03.2005, deklarues S. dhe D. K., për shtëpi banimi ***-katëshe, sip. 120 m², truall 500 m², adresa: Rr. “****”, Njësia Nr. ***, ndërtuar në tetor të vitit 1995.
- Sqarim në kuadër të plotësimit të formularit për legalizim banese, për Bashkinë Tiranë, Njësia Nr. ***, z. S. K., sqaron se: “1. Trualli mbi të cilin kemi ndërtuar ka qënë inproduktiv. 2. Meqënëse ka qënë në këtë gjendje i janë paguar banorëve vlera prej 1.000.000 lekësh dhe për formimin e tokës janë shpënzuar 300.000 lekë. 3. Kjo lagje është e banueshme përpara vitit 1990 dhe trualli që ka banesa nuk ka as pronar të vjetër dhe as pronar të ri”.
- 2 certifikata familjare.
- Tre mandatarkëtime nr. ***, *** dhe ***.

⁴Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 02.02.2018, me të cilën është kërkuar tek ALUIZNI, informacion mbi aplikim/vetëdeklarim për procedura legalizimi.

2.5 Gjithashtu, Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë⁵, me shkresën nr. ***prot., datë 27.11.2018, ka informuar Komisionin se është proceduar me kualifikimin e objektit informal dhe emetimin e lejes së legalizimit në favor të subjekteve, S.K. dhe D.K., bazuar në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, i ndryshuar, si dhe VKM-së, nr. 280/2015 “Për përcaktimin e kriterëve procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”.

2.6 Nga verifikimi i dokumentacionit depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, formulari “Vetëdeklarim për Legalizim”, rezulton gjithashtu edhe një formular sqarues për legalizim banese, ku deklarohet nga z. S.K., në lidhje me truallin ku ishte ndërtuar banesa, i ka paguar disa banorëve shumën prej 1.000.000 lekësh. Mbi këtë konstatim, Komisioni, më datë 13.11.2018, i kërkoi subjektit që të depozitojë mandatarëkëtimet për shumatat e deklaruara se u ishin paguar banorëve.

2.7 Mbi kërkesën e Komisionit, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, më datë 16.11.2018, ka dërguar dokumentacionin;

- **Deklaratë noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2018**, përmes së cilës shtetasi z. S.K., ka deklaruar se në lidhje me sipërfaqen e truallit prej 1000 m² (gjysma i takon vëllait të tij), i ka paguar shtetasve H. dhe Q. H., banor në lagjen “****”, shumën prej 380.000 lekësh, pasi këta të fundit ishin paraqitur si pronar të tokës në fjalë. Shpenzimet e deklaruara si të paguar prej 1.000.000 lekësh, përfshinë dhe shpenzime punimi në truall.

-**Deklaratë e thjeshtë, datë 31.10.1996**, nga shtetasit H. dhe Q. H., të cilët kanë deklaruar se kanë marrë nga shtetasi S.K., shumën prej 380.000 lekësh, dhe se i japin këtij personi tokën në pronësi të tyre. Deklarata rezulton e nënshkruar nga shtetasit H. dhe Q. H., shtetasi S. K., si dhe nga një dëshmitar tjetër.

2.8 Pas shqyrtimit të dokumentacionit sipërcituar, Komisioni, më datë 21.11.2018, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë saktësisht vitin e ndërtimit të shtëpisë në proces legalizimi, shpenzimet e ndërtimit, mobilimit si dhe të justifikohet burimi i ligjshëm i tyre, mbështetur në dokumentacion ligjor provues.

2.9 Subjekti i rivlerësimit, më datë 26.11.2016, ndër të tjera deklaroi se: “Kjo shtëpi banimi kishte filluar të ndërtohet rreth viteve 1995-1996. Në atë kohë subjekti i rivlerësimit kishte qenë në vitin e dytë, në gjimnazin "Ismail Qemali", Tiranë. Sipas vërtetimit lëshuar nga ALUIZNI, rezulton se në lidhje me këtë banesë ishte aplikuar për legalizim, më datën 20.03.2005. Ndërkohë, sipas certifikatës së martesës, subjekti kishte lidhur martesë me shtetasin D. K. (djalin e shtetasit S. K.), më datën 31.01.2011. Subjekti deklaroi se ka qenë e vazhdon të jetë përdoruese e kësaj banese, për shkak të martesës me shtetasin D.K. dhe jo pronare e saj. Sipas Kodit të Familjes çdo pasuri e fituar para martesë, nuk përfshihet në pasurinë bashkëshortore (siç është banesa konkrete). Gjithashtu sipas ligjit për legalizimin, pronar të pasurisë, për të cilën aplikohet për legalizim, janë personat që kanë qenë pjesë e përbërjes familjare në momentin e aplikimit për legalizim (datë 20.03.2005, ndërkohë martesë e saj me shtetasin D.K. është bërë në vitin 2011, pra nuk kishte qenë pjesë e përbërjes familjare në momentin e aplikimit për legalizim). Në kuptim të ligjit nuk ishte, apo bëhej asnjëherë pronare e banesës në fjalë, as pas përfundimit të procesit të legalizimit, pasi nuk kishte qenë në përbërjen familjare në momentin që ishte aplikuar për legalizim dhe se bëhej fjalë për

⁵ Shih në doje shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 14.11.2018, drejtuar ALUIZNI-t, me anë të së cilës i është kërkuar informacion mbi vijimin e procedurave të legalizimit për ndërtimin në procedurë legalizimi.

veprime të cilat ishin kryer rreth 16 vite para se të marrohej me shtetasin D.K. (djalin e aplikuesit për legalizim shtetasit S.K.).

2.10 Për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve nga ana e subjektit, si dhe për të verifikuar nëse kishte pasur punime shtesë në këtë shtëpi, Komisioni, kërkoi informacion pranë Njësisë Administrative Nr. ***, e cila me shkresën nr. ***prot., datë 19.11.2018, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik⁶ të datës 26.11.2018, ka informuar Komisionin se shtetasit S. dhe D. K., nuk kanë aplikuar për kryerje punimesh në bazë të VKM-së, nr. 408, datë 15.05.2015, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, nga viti 2015 e në vijim.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.

Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve të dala nga hetimi i thelluar, analizim të provave të administruara, deklaratimet e subjektit, si dhe ligjin e zbatueshëm, arsyeton se:

Për pasurinë, shtëpi private, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, në proces legalizimi, aplikuar në vitin 2005, pranë ALUIZNI-t, nga shtetasit S. K. dhe D. K., rezulton e konfirmuar⁷ nga ky institucion se është proceduar, me kualifikimin e objektit informal dhe emetimin e lejes së legalizimit, po në favor të shtetasve aplikues, S. K. dhe D. K.

Fakti se kjo shtëpi ishte ndërtuar në tetor të vitit 1995, rezulton i pasqyruar/deklaruar nga shtetasit S. dhe D. K., edhe në formularin e vetëdeklarimit për legalizim, datë 20.03.2005, për shtëpi banimi *** kate, sip. 120 m², truall 500 m², me adresë: Rr. “****”, Njësia Administrative Nr. ***. Gjithashtu, ka rezultuar se në kuadër të plotësimit të formularit për legalizim banesë, shtetasit S.K., ka deklaruar se: *“Trualli mbi të cilin është ndërtuar ka qenë inproduktiv, e meqenëse kishte qenë në atë gjendje i ka paguar banorëve vlerën prej 1.000.000 lekësh dhe për formimin e tokës kishte shpenzuar shumën 300.000 lekë”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit, të depozituar nga aplikuesit pranë ALUIZNI-t, të administruar nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nuk ka qenë në trungun familjar të familjes “Kolgjoka” në vitin 2005, momenti i aplikimit për legalizim, si dhe nuk rezulton të këtë ndonjë rrethanë ligjore që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë investim apo shpenzim të mundshëm mbi këtë pasuri. Në vitin 2005, kur është bërë aplikimi për legalizim shtëpisë rezulton se subjekti ka qenë në vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të çertifikatës së martesës, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i subjektit, kanë lidhur martesë në datë/viti 31.01.2011. Trupi gjykues duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në martesë në vitin 2005, viti i aplikimit për regjistrim pranë ALUIZNI-t (pra 6 vite më vonë), si dhe as në detyrë “ex officio”, vlerëson se këto rrethana ligjore e përjashtojnë atë nga ndonjë kualifikim të mundshëm si “person të lidhur”, apo “personit tjetër të lidhur” në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në këtë përfundim, përse kohë gjatë hetimit administrativ, nuk i rezultoi as ndonjë rrethanë tjetër, që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë investim apo shpenzim të mundshëm në këtë pasuri.

Në përfundim lidhur me këtë pasuri, në analizim të fakteve dhe rrethana trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në bazë të përgjigjeve të ardhura nga insitucionet si dhe nuk ngrihen dyshime për këtë aset.

⁶Shih dosjen e subjektit, përkatësisht komunikimit elektronik me e-mail, të kryer nga Komisioni, më datë 26.11.2018, drejtuar Njësisë Administrative Nr. ***, dhe përgjigjes ardhur nga juristja e kësaj njësie.

⁷ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 07.12.2018.

3. Gjendje *cash* në shtëpi në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

3.1 Burimi i gjendjes *cash*, deklaruar nga subjekti se burimi i kësaj shuma është nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit.

3.2 Nga verifikimi i burimeve (të ardhurave) të deklaruara, nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura të cilat justifikojnë gjendjen *cash*, në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë”.

3.3 Në përfundim konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme për krijim e gjendjes “*cash*” 200.000 (dyqind mijë) lekë”.

4. Derdhje 2.100.000 lekë (dy milion e njëqind mijë)⁸ lekë, në bankën “Raiffeisen”, sipas mandatit, datë 25.01.2017, bashkëlidhur, me burim nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit të subjektit.

Për të dy asetet, gjendje likuiditeti, cituar në pikën 3 dhe 4, mësipërm subjekti ka deklaruar se burimin e ka nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit, sipas deklarimit të të ardhurave dhe dokumentacionit provues:

Deklarimi i të ardhurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka⁹.

Deklarimi i të ardhurave të personit të lidhur, për bashkëshortin¹⁰ e subjektit.

Nga hetimi administrativ i Komisionit për këtë pasuri, ka rezultuar se:

4.1 “Raiffeisen Bank”¹¹, me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2018, ka informuar Komisionin, se z. D. S. K., disponon llogari në lekë me gjendje **2.100.178** lekë.

4.2 Lidhur me këtë shumë likuiditetesh, Komisioni, kreu analizën financiare në vite për të verifikuar nëse subjekti dhe personi i lidhur ka pasur burime të ligjshme financiare për të krijuar shumën e vendosur në depozitë.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni reflektuar si më poshtë:

Tabela nr. 2

	Përshkrimi	2014	2015	2016
1	PASURI	560.440	120.663	0

⁸Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës (aneksi 4/4), mandat RFZ, datë 25.01.2017, shuma 2.100.000 lekë;

⁹ Subjekti për të provuar të ardhurat e realizura në vite ka depozituar:

Vërtetim nr. ***, datë 23.01.2017, nga Shkolla e Magjistraturës, periudha 2005 - 2007.

Vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, periudha 2007 - 2009.

Vërtetim nr. ***, datë 20.01.2017 dhe nr. 19, datë 20.01.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, periudha 2009 - 2017.

Vërtetim nga ISSH-ja, nr. ***, për periudhën 20.12.2010 - 02.08.2011.

Vërtetim nga ISSH-ja, nr. ***, për periudhën 11.01.2016 - 14.3.2016.

Shtesë sqaruese, nr. ***, datë 24.03.2017, nga kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. Alma Kolgjoka. Totali i të ardhurave në vlerën 9.305.514 lekë.

¹⁰ Vërtetim nr. ***, datë 25.10.2016, nga Drejtoria e Policisë, për periudhën 2005 - 2009. Shuma 2.243.132 lekë. Vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga Drejtoria e Policisë, periudha 01.12.2009 - 31.12.2011. Shuma 1.176.232 lekë.

Vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016, nga Drejtoria e Policisë Tiranë, për periudhën 01.12.2011 - 31.03.2013, shuma në total 787.544 lekë.

Vërtetim nr. ***, datë 24.10.2016, nga Drejtoria e Policisë Vlorë, periudha 01.04.2013 - 02.06.2013, shuma 108.565 lekë.

Vërtetim nr. ***, datë 07.10.2016, nga Drejtoria e Policisë Kukës, për periudhën 12.06.2013 - 18.12.2013 dhe 19.12.2013 - 30.4.2014. Shuma 238.994 lekë.

Vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga Ministria e Punëve të Brendshme, për periudhën 01.04.2014 - 18.06.2016. Shuma 1.969.630 lekë.

Vërtetim nr. ***, datë 27.10.2016, nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, për periudhën 20.06.2016 - 30.09.2016. Shuma 264.670 lekë.

Vërtetim page nr. ***, datë 24.01.2017 nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, për periudhën 01.10.2016 - 31.12.2016. Shuma 206.990 lekë.

Totali i të ardhurave 6.995.757 lekë.

¹¹Në dosjen e subjektit ndodhet shkresa e Komisionit, nr. *** prot., datë 05.02.2018, me të cilën është kërkuar informacion dhe të dhëna bankare nga 27 banka dhe institucione financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

		Blerë, automjet, "Audi A6" ***	560.440	120.663	0
2	TË ARDHURA		2.135.369	2.167.090	2.082.722
		Të ardhura subjekti	1.433.576	1.269.917	1.084.752
		Të ardhura bashkëshorti	701.793	897.173	997.970
3	SHPENZIME		482.143	509.673	683.438
		Shpenzime jetese	482.143	482.143	642.857
		Shpenzime udhëtimi	0	27.530	40.581
4	LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT		24.756	500.000	1.500.000
		"NBG", A. K.	7576	7950	8142
		"Raiffeisen Bank", Alma Kolgjoka	17.145	92.453	492.646
		"Raiffeisen Bank", D. K.	35	-60	10.254
		CASH	0	399.657	988.958
5	LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT		500.000	1.500.000	2.300.000
		"NBG" A. K.	7.950	8.142	8.279
		"Raiffeisen Bank", Alma Kolgjoka	92.453	492.646	24.210
		"Raiffeisen Bank", D. K.	-60	10.254	874
		CASH	399.657	988.958	2.266.637
		DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI- SHPENZIME 2+4-1-3-5)	617.542	536.754	599.284

4.3 Nga analiza financiare, Komisioni, konstatoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj, kanë pasur burime të ligjshme për shpenzimet e kryera dhe pasurinë e krijuar (*përfshirë likuiditetet në shumën 2.300.000 lekë*) gjatë viteve që ka pasur detyrimin për deklaram.

Arsyvetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, lidhur me këto shuma likuiditetesh nisur nga vlerësimi i deklarimeve periodike të subjektit, nga ku i ka rezultuar se subjekti në vite ka pasur kursime (*shtesë të likuiditeteve*), të deklaruara, si dhe analizën financiare të kryer, çmon se subjekti dhe personi i lidhur me të, kanë pasur mundësi financiare që të krijojnë shumën e depozituar në bankë si dhe të përballojë shpenzimet e tjera sipas deklarimeve.

Në përfundim, Komisioni, konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme për krijim e likuiditetit, derdhje 2.100.000 lekë (dy milion e njëqind mijë lek)¹², në "Raiffeisen Bank".

5. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, konstatoi disa adresa të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, në pyetësorin standard, si dhe gjatë verifikimit pranë sistemit të OSHEE-së.

5.1 Lidhur me këto adresa, Komisioni, hetoi mbi faktin nëse subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar, ndonjë pasuri në pronësi, posedim, përdorim, apo me qira për pasuritë lidhur me adresat e më poshtme:

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës (aneksi 4/4), mandat RFZ, datë 25.01.2017, shuma 2.100.000 lekë.

a) Viti 2007 - 2009, adresë e deklaruar, Lagjja: Nr. ***, Rr. “****”, pll. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë; Kjo adresë i përkiste pasurisë së prindërve të subjektit, konfirmuar nga ana e ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.02.2018.

b) Viti 2010 adresa e deklaruar, Njësia Bashkiake Nr. ***, Rr. “****”.

c) Viti 2011 - 2016, adresa e deklaruar, Njësia Bashkiake Nr. ***, Rr. “****”, shtëpi private nr. ***, Tiranë. Këto adresa, sipas dokumentacionit të ALUIZNI-t, Njesisë Administrative Nr. ***, lidhen me shtëpinë në proces legalizimi të deklaruar nga subjekti.

ç) Në pyetësonin standard të Komisionit, datë 01.03.2018, subjekti kishte deklaruar se: *“Duke filluar nga muaji shtator 2017 e në vijim, për shkak të futjes së vajzës A. K në klasë të parë, për shkak të afërsisë së shkollës me shtëpinë e prindërve të mi, përkohësisht në ditë të ndryshme kam qëndruar tek shtëpia e prindërve të mi, në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Rr. ” ****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë. Në vijim, Komisioni, konstatoi se kjo adresë nuk figuronte si ndonjë pasuri në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit.*

d) Komisioni kreu verifikimet edhe pranë OSHEE-së, dhe UKT-së, nga ku rezultoi se në emër të babait të subjektit figurojnë kontrata furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, si më poshtë:

- Kontrata me nr. ***, në emër të z. S. H., me adresë: Rr. “****”, me datë hapje 11.05.2011.
- Kontrata me nr. ***, në emër të z. S. H., me adresë: Rr. “****”;
- Kontrata me nr. ***, në emër të z. S. H., me adresë: Rr. “****”;
- Kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me nr. ***, për objektin në adresë: Rr. “****”, pll. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë.
- Kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me nr. ***, për objektin në adresë Rr. “****”, Tiranë.

5.2 Për këto adresa, e të dhëna që rezultuan nga hetimi, Komisioni i kërkoi dhe morri deklarime subjektit të rivlerësimit, e cila në datë 22.10.2018, ka deklaruar se:

5.2.1 Në lidhje me adresën e parë: *“Njësia Administrative Nr. ***, Rr: ” ****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë”, pasuri e deklaruar nga subjekti në pyetësonin standard të Komisionit, datë 01.03.2018, ishte në pronësi të babait të saj, shtetasit S. A. H. Për të provuar këtë fakt ka paraqitur “Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme me rezerve” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.07.2012. Në lidhje me këtë apartament, ka sqaruar se ende nuk ishin bërë ndryshimet pranë ZVRPP-së Tiranë për kalimin e pronësisë dhe se nga ana e saj ishte deklaruar adresa e re që ky apartament dispononte aktualisht, pas përditësimit të adresave...”. Për të vërtetuar këtë fakt ka paraqitur, kopje të njoftimit të adresës së re ndodhur në derën e apartamentit. Gjithashtu për të vërtetuar këtë pretendim ka paraqitur kopje të hartës së Rrjetit Rrugor të Njesisë Bashkiake Nr. ***, ku ndodhet edhe apartamenti në pronësi të babait të saj, me identifikimin e rrugës përkatëse, si dhe harta e emërimit të rrugëve të Bashkisë Tiranë.*

5.2.2 Në lidhje me adresën e dytë: Rr. “****”, subjektit ka deklaruar se: *“Kontrata e furnizimit me OSHEE-në, nr. ***, në emër të babait të saj, shtetasit S. H. i përket pikërisht apartamentit që ishte deklaruar nga ana e saj se përkohësisht, “...se në ditë të ndryshme kishte qëndruar për shkak të afërsisë së shkollës së vajzës...”. Pra bëhej fjalë për të njëjtin apartament, për të cilin babai i saj ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë datë 30.07.2012, dhe apartamentin e deklaruar nga ana e saj në pyetësonin standard të Komisionit, datë 01.03.2018. Në vijim ka sqaruar se: “.... si kontrata e shitblerjes dhe kontrata e furnizimit me OSHEE-në kishin të pasqyruar adresën e vjetër që ka pasur ky apartament (Rr. “ ****”), kurse nga ana e saj, ishte deklaruar si adresë, adresa e re e këtij apartamenti, për të cilin ishin venë në dijeni nga njoftimi i ngjitur tek dera e apartamentit.¹³”.*

¹³...sqarohet se pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë, më datë 30.07.2012, nga babai i saj, shtetasit S. H., më datë 02.11.2012, është kërkuar pranë OSHEE-së ndryshimi i emrit nga *** (firma ndërtuese) te blerësi S. H. Për të provuar këtë

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, lidhur me këto adresa vlerëson se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, kopje të hartës së Rrjetit Rrugor të Njësisë Bashkiake Nr. *, "Formular ankesë/kërkese", nr. serie ***, datë 02.11.2012, drejtuar OSHEE-së, kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me rezerve, nr. *** rep.,nr. *** kol., datë 30.07.2012, kanë qartësuar lidhjen e subjektit me këto adresa, për të cilat Komisionit, **duke vlerësuar faktet e dala nga hetimi i thelluar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, çmon se nuk ka dyshime për pasuri të paluajtshme në pronësi, përdorim, apo me qira, në lidhje me adresat e deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit.****

Gjithashtu, gjatë hetimit të thelluar, nga gjendja e akteve në dosje, trupi gjykues konstatoi se babai i subjektit, me anë të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, ka blerë një apartament me sipërfaqe 141.87 m², në vitin 2012. Trupi gjykues edhe në këtë drejtim verifikoi rrethanat nëse subjekti mund të vishej, me ndonjë kualifikim të mundshëm si "*person i lidhur*", apo "*personit tjetër i lidhur*" në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi rrethanat se, subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në vitin 2011 dhe ka dalë me certifikatë më vete me familjen e saj të re, dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016, në periudhën që babai i saj ka blerë apartamentin (viti 2012), nuk e kualifikon atë si "*person të lidhur*", apo "*personit tjetër të lidhur*" në mënyrë që të bëhej vlerësimi i burimeve të ligjshme për këtë pasuri. Trupit gjykues, arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë, nga hetimi administrativ nuk i rezultoi ndonjë rrethanë tjetër ligjore, që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë kontribut/shpenzim të mundshëm të saj mbi këtë pasuri.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, i rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultoi të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si "**DSIK**"), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin "DH" të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar Raportin mbi kontrollin e figurës, nr. *** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.

fakt ka paraqitur "Formular ankesë/kërkese" nr. *** serie, datë 02.11.2012, drejtuar OSHEE-së. Më pas ndryshimi i emrit është bërë edhe te kontrata e UKT-së, nr. ***.

Komisionit nga hetimi administrativ, nuk i rezultoi asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundimin, trupi gjykues arrin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Alma Kolgjoka.

Raporti është bazuar mbi analizimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

KLD-ja, në vlerësimin e saj është bazuar në: Formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Nga ky institucion, është konstatuar se:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, është magjistrate e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Ajo ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor. Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës dhe duke parashtruar pyetje të qarta për ta.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të kodit si dhe ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale dhe në të drejtën procedurale civile, lidhur me vërtetimin e faktit, pavërtetësinë e dokumentit pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv apo në të drejtën familjare.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në 3 raste, gjykatat më të larta kanë vendosur lënien në fuqi të vendimeve të dhëna prej saj. Ndërsa në 3 raste të tjera, është vendosur mospranimi i ankimit nga Gjykata e Apelit për shkak të heqjes dorë prej tij apo për shkak të mosrespektimit të afatit të ankimit nga ana e apellesit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.

Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Në përgjithësi nuk përdor referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta, por në rastet e gjykimit penal të shkurtuar i referohet vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për vitet 2013 – 2016, gjithsej 1737 çështje dhe ka përfunduar si kryesuese 1464 çështje, duke mbartur vitin e fundit 53 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 84.2 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë për efekte të organizimit të shortit konstatohet se, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtare Alma Kolgjoka ka përfunduar 1049 çështje gjyqësore, nga të cilat 567 çështje penale (141 penale themeli dhe 426 kërkesa penale) si dhe 482 çështje civile (295 civile themeli, kërkesa civile dhe familjare, 6 heqje zotësie, 36 urdhër mbrojtje dhe sigurim padie, 145 kërkesa të tjera civile).

Sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjes civile me palë kundërshtarë. Nga ana tjetër, shkronja k) e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimi, ka përcaktuar se kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale respektivisht në masën 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Alma Kolgjoka, i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në çdo rast afatet ligjore.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, përgjithësisht e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe i kushton rëndësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje menjëherë me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Gjatë gjykimit, gjyqtarja Alma Kolgjoka, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre dhe përgjithësisht me bazë ligjore. Distanca kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë. Janë konstatuar 4 seanca gjyqësore të planifikuara në kohë të tejzgjatur, të cilat janë justifikuar në procesverbalin gjyqësor me lejen vjetore të muajit gusht

apo me festat e fund vitit e mbartjen e dosjeve. Përgjithësisht, ajo ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit, megjithëse janë identifikuar edhe raste kur seanca gjyqësore ka dështuar për shkak të njoftimit.

Gjyqtarja Alma Kolgjoka, zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtës, ndonëse duhet të disiplinojë më mirë sjelljen e mbrojtësve në gjykim për të shmangur tejzgjatjen e procesit gjyqësor.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur, pasi mungon gjyqtarja, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëhirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Alma Kolgjoka ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 04.07.2001 dhe titullin “Magjistrit gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2008. Pas studimeve, në datën 25.03.2009, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Në vijim, më 11.07.2014, emërohet kryetare e kësaj gjykate, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Alma Kolgjoka. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka. Për vetë gjyqtarën Alma Kolgjoka në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Alma Kolgjoka komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndonëse janë evidentuar raste, që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo dështim të seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve, që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 10 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (*shih, trajnimet në 3 vitet e fundit*). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 16 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në seksione. Nuk dokumentohet që gjyqtarja Alma Kolgjoka të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës.

I. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Alma Kolgjoka ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, më datë 04.07.2001, dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2008. Pas studimeve, më datë 25.03.2009, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Në vijim, më datë 11.07.2014 emërohet kryetare e kësaj gjykate, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Alma Kolgjoka janë paraqitur gjithsej 9 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2013, 7 ankesa në vitin 2014, dhe 1 ankesë në vitin 2015). 7 ankesa (6 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 2 me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 4 me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë dhe 1 ankesë me pretendimin së është jashtë kompetencave të shqyrtimit nga Inspektorati KLD-së.

2 ankesa të tjera janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe rezultatet e tyre janë si vijon:

- i. 1 ankesë e vitit 2013 i është regjistruar gjyqtarës për vlerësim profesional dhe etik, pasi është konstatuar se gjykimi i çështjes civile, nr. *** akti, datë 13.09.2012 regjistrimi, me objekt padie: “***” dhe objekt kundërpadie: “***” ka zgjatur 1 vit, 7 muaj e 27 ditë, duke tejkaluar me 1 vit 1 muaj e 27 ditë afatin standard 6 mujor të Sistemit të Vlerësimit. Për shkak të kompleksitetit që ka pasur çështja dhe sjelljes së palëve në proces, është konkluduar se rasti konkret nuk mbështet përshtatshëm një procedim disiplinor dhe për këtë shkak, kjo ankesë i është regjistruar asaj për vlerësim profesional dhe etik;
- ii. 1 ankesë e vitit 2014 është arkivuar pasi pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara në ligj e në prova.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Alma Kolgjoka, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

MBI VEPRIMTARINË E KRYETARIT¹⁴

Përveç vlerësimit si gjyqtar, Komisioni, në zbatim të nenit 79, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka kryer vlerësimin e subjektit të rivlerësimit për përmbushjen e detyrave funksionale si kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Në mënyrë që Komisioni të bënte një vlerësim të aftësive drejtuese dhe organizative, në kushtet kur në raportin e KLD-së, nuk ishte vlerësuar subjekti i rivlerësimit sa i përkiste aspektit drejtues, Komisioni bazuar në kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit në zbatim të nenit 79 e vijues të ligjit nr. 96/2016, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit informacion nëpërmjet pyetësorit, më datë 02.11.2018, sipas të cilës subjekti ka dhënë informacion dhe detaje për punën si drejtuese institucionit:

Këto aftësi u vlerësuan përmes kërkesave të Komisionit sa më poshtë referohet si dhe përgjigjeve të subjektit sipas pyetësorit, më datë 08.11.2018, ku është argumentuar:

1. Mbi njohjen e raporteve vjetore për vitet 2016 dhe 2017 që subjekti kishte dërguar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Subjekti i rivlerësimit¹⁵ ka argumentuar se analizat vjetore organizohen nga KLD-ja, mbi bazën e njoftimit zyrtar drejtuar gjykatës përkatëse. Analiza e fundit vjetore ishte organizuar nga KLD-ja në vitin 2016 në ambientet e Gjykatës së Apelit Tiranë në rang gjykatash të shkallës së parë, që janë pjesë e juridiksionit të kësaj gjykate, në lidhje me të dhënat statistikore që i përkasin vitit 2015¹⁶.

¹⁴Për më shumë refero shpjegimet e dokumentacionin e dërguar nga subjekti

¹⁵Bashkëngjitur subjekti ka vendosur shkresat:

a) Shkresa nr. *** prot., datë 17.01.2017, drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për vitin 2016.
 b) Shkresa nr. *** prot., datë 10.01.2018 drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për vitin 2017.
 c) Shkresa nr. *** prot., datë 13.04.2016 drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 3-mujorin e parë të vitit 2016.
 d) Shkresa nr. *** prot., datë 11.07.2016, drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 6-mujorin e parë të vitit 2016.
 e) Shkresa nr. *** prot., datë 03.10.2016 drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 9-mujorin e vitit 2016 (me pas është çuar, shkresa nr. *** prot., datë 17.01.201, e sipërcituar në lidhje me volumin e punës për gjithë vitin 2016).
 f) Shkresa nr. *** prot., datë 04.04.2017, drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 3-mujorin e parë të vitit 2017.
 g) Shkresa nr. *** prot., datë 10.07.2017, drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 6-mujorin e parë të vitit 2017.
 gj) Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2017, drejtuar KLD-së, në lidhje me volumin e punës për 9-mujorin e vitit 2017 (me pas është çuar, shkresa nr. *** prot., datë 10.01.2018, e sipërcituar në lidhje me volumin e punës për gjithë vitin 2017).

¹⁶Referoju shpjegimeve të subjektit, sipas e-mail-it, të datës 08.11.2018.

2. Në lidhje me mirëorganizimin e gjykatës në dhoma ose seksione (pika 2/ a e nenit 80, të ligjit nr. 96/2016):

Komisioni, i kërkoi subjektit të rivlerësimit, që të prezantonte një përmbledhje të strukturës së gjykatës ku ushtron funksionin e kryetares, duke paraqitur seksionet/departamentet përkatëse, numrin e gjykatësve në secilin prej këtyre seksioneve/ departamenteve/ dhomave përkatëse që janë krijuar, dhomat civile dhe dhomat penale.

Pas shpjegimeve të subjektit, si dhe dokumentacioni dërguar nga ana e saj, shkresat nr. *** prot., datë 16.02.2015, dhe nr. *** prot., datë 21.04.2016, vërehet se subjekti ka ndërmarrë veprime që tregojnë cilësi organizative të saj për mirëorganizimin e kësaj gjykate.

3. Në lidhje me planifikimin e çështjeve të ngutshme, pika 2/c, e ligjit nr. 96/2016:

Lidhur me këtë çështje, pas shpjegimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit dërguar prej saj, urdhri nr. *** prot., datë 05.01.2016, "Për organizimin e punës në gjykatë" nxjerrë në fillim të vitit 2016, dhe urdhri nr. *** prot., datë 04.01.2017, "Për organizimin e punës në gjykatë" nxjerrë në fillim të vitit 2017, urdhri nr. *** prot., datë 27.07.2016, "Për organizimin e punës gjatë muajit të lejes vjetore gusht 2016" dhe urdhri nr. *** prot., datë 24.07.2017, "Për organizimin e punës gjatë muajit të lejes vjetore gusht 2017", Komisioni, vëren se janë marrë masa organizative të duhura lidhur me këtë aspekt.

4. Në lidhje me organizimin nga ana e kryetarit për sistemin/mënyrën për ndarjen e çështjeve gjyqësore (pika 2. c, e ligjit nr. 96/2016).

Subjekti ka argumentuar se shorti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë hidhet në mënyrë elektronike, sipas sistemit *ICMIS*, dy herë në javë, ditën e martë dhe të enjte, pas depozitimit të çështjeve tek kancelari. Kjo procedurë është aplikuar në përputhje me vendimin, nr. *** , datë 24.12.2008, të KLD-së "Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", me qëllim hedhjen në short të kërkesave brenda afatit 7 ditor, të kërkuar në këtë vendim.

5. Në lidhje me masat organizative që subjekti kishte marrë për të reduktuar numrin e çështjeve të prapambetura në këtë gjykatë:

Subjekti¹⁷ ka argumentuar se për sa i përket reduktimit të numrit të çështjeve të prapambetura (të mbartura) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka pasur aplikimi i projektit "Për një drejtësi pa vonesa" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Në këtë drejtim, Komisioni vëren se nga ana e subjektit, janë kryer përpjekje përmes kërkesave zyrtare për shtesë të organikës në këtë gjykatë¹⁸.

6. Në lidhje me metodologjinë që ishte zbatuar për të mbikëqyrur kryerjen e detyrave nga secili prej gjykatësve (rendimentin, respektimin e afateve...)

Subjekti ndër të tjera, ka argumentuar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, detyrat e trupit gjyqësor dhe të administratës dhe mënyra e mbikëqyrjes së tyre janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme në "*Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*" miratuar nga ana e saj, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, me urdhrin nr. *** prot., datë 06.01.2014, dhe se nga ana e saj synohet nxitja në mënyrë të vazhdueshme për

¹⁷Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

a) Certifikata dhënë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë në shenjë mirënjohje për zbatimin e suksesshëm të nismës "Për një drejtësi pa vonesa".

b) Prezantimi i projektit "Për një drejtësi pa vonesa" në Konferencën Kombëtare Gjyqësore.

¹⁸Më shumë refo ro shpjegimeve të subjektit të datës 08.11.2018.

përfundimin e gjykimeve brenda një afati sa më të arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve në kohë, etj.

7. Mbi pasqyrimin e një përmbledhjeje të numrit të ditëve të lejes (leje vjetore dhe leje e veçantë) që subjekti kishte dhënë për gjykatësit përkatës në vitin 2016 dhe 2017.

Lidhur me këtë çështje, subjekti ndër të tjera ka argumentuar dhe dokumentuar se gjyqtarët janë caktuar sipas grafikut të gatishmërisë për periudhën e daljes në punë për kryerjen e veprimeve të ngutshme gjatë muajit gusht, pjesën tjetër të lejes e kanë kryer në një periudhë të caktuar të vitit, sipas kërkesës së tyre, formalizuar në urdhrat nr. *** prot., datë 27.07.2016, dhe nr. *** prot., datë 24.07.2017.

8. Mbi pasqyrimin e takimeve të përgjithshme të organizuara në 2016 dhe në 2017 dhe çështjet që diskutohen në këto takime.

Ndër të tjera subjekti ka argumentuar se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, kjo çështje gjen parashikim në "Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë" miratuar me urdhrin nr. *** prot., datë 06.01.2014, dhe urdhrat e fillim vitit, për qëllim rritjen e profesionalizmit të gjyqtarëve, ku diskutohen vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendime të Gjykatës Kushtetuese, praktika gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut e gjykatave të tjera, vendime të KLD-së, akte kontrolli dhe inspektive të ushtruara nga Inspektorati i KLD-së dhe Ministrisë së Drejtësisë.

9. Mbi komunikimin e brendshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Në mënyrë të hollësishme mënyra e organizimit, funksionimit dhe komunikimit gjendet e pasqyruar në "Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë" miratuar me Urdhrin nr. *** prot., datë 06.01.2014. Gjithashtu komunikimi i brendshëm kryhet edhe në mënyrë të shkruar, me urdhra të brendshëm, për zgjidhjen e problematikave të caktuara, disa prej të cilave subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes¹⁹.

10. Në lidhje me iniciativën që subjekti kishte marrë gjatë 3 viteve të fundit për të përmirësuar funksionimin e gjykatës:

Subjekti ndër të tjera²⁰, ka argumentuar se si kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, gjatë 3 viteve të fundit, ka ndërmarrë iniciativa të fokusuara për të garantuar rritjen e besimit të publikut tek drejtësia (*përfundimi i gjykimeve brenda një afati të arsyeshëm, respektimi i solemnitetit dhe etikës nga trupi gjyqësor, përdorimi në çdo gjykim të sistemit audio për të rritur në maksimum transparencën, respektimin e disiplinës në punë duke instaluar pajisjen e hyrjes në gjykatë me kartë, etj.*), ngritjen e aftësive profesionale të trupit gjyqësor dhe administratës, krijimin e një praktike të njehsuar për gjithë gjykatën për çështje të ngjashme, etj. Është mundësuar që publiku të ketë mundësi të kontaktojë në çdo moment me kancelarin dhe punonjësen e arkivës gjatë orarit zyrtar, për t'ju shërbyer me mënyrë maksimale. Është mundësuar ndërtimi i rampës, për të bërë të mundur aksesin në gjykatë edhe të personave me aftësi ndryshe, janë ndryshuar dhe shtuar numri i kamerave të sigurisë në gjykatë, etj.

Në vijim, lidhur me kriterin profesional, komisioni konstatoi se referencat mbi të dhënat e kriterëve të aftësive profesionale, tregojnë se subjekti i rivlerësimi;

¹⁹a) Urdhër nr. *** prot., datë 06.01.2014, me të cilin është miratuar "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, bashkëngjitur.

b) Urdhër nr. *** prot., datë 23.11.2015. c) Urdhër nr. *** prot., datë 17.12.2015. d) Urdhër nr. *** prot., datë 25.03.2016. e) Urdhër nr. *** prot., datë 31.03.2016. ë) Urdhër nr. *** prot., datë 31.03.2016. f) Urdhër nr. *** prot., datë 31.03.2016. g) Urdhër nr. *** prot., datë 31.03.2016. h) Urdhër nr. *** prot., datë 31.03.2016. i) Urdhër nr. *** prot., datë 02.06.2016. j) Urdhër nr. *** prot., datë 29.12.2016. k) Urdhër nr. *** prot., datë 27.12.2017.

²⁰Refero shpjegimet e subjektit të datës 08.11.2018.

- Respekton afatet e gjykimit brenda afatit standarde sipas Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit²¹.
- Rezulton të jenë respektuar të drejtat e palëve mbi njoftimet e tyre për seancë dhe të drejtat procedurale.
- Vendimet rezultojnë të jenë të arsyetuara, pasi ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti i rivlerësimit, duke i kushtuar rëndësi analizës së normës ligjore.
- Rezulton, të jenë mbajtur vendime të ndërmjetme të plota të gjykatës gjatë procesit si dhe dispozitivi i vendimit përfundimtar, të pasqyruara edhe në procesverbalet gjyqësore.
- Rezultuan 2 raste të zgjatjes së afateve të gjykimit, por nisur nga analizimi i shkaqeve të paraqitura dhe rëndësia e natyra e çështjes, vërehet se këto shtyrje të seancave kanë qenë në pjesën më të madhe të tyre për shkaqe ligjore.
- Rezulton se subjekti i rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe deklaratimet e dhëna, ka treguar përpjekje të vazhdueshme duke marrë masa organizative, për të realizuar detyrat si kryetare gjykate, vlerësuar kjo dhe në raport me numrin e gjyqtarëve që ka kjo gjykatë.

Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka: “E aftë”.

Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

Denoncime të paraqitura pranë Komisionit

Pranë Komisionit janë paraqitur 5 denoncime për subjektin e rivlerësimit, si më poshtë vijon:

1. Denoncim nr. * prot., datë 17.10.2018. Denoncues, z. Sh. M.**

1.1 KLD-ja, në shkresën me nr. *** prot., datë 30.10.2018, argumenton se ankesa e z. Sh. M, nuk përmbush kriteret për t’u shqyrtuar nga Inspektorati i KLD-së, sipas parashikimeve të nenit 120 pika1/c, të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se: *“Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret: kur ankesa nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues”*.

1.2 Në shpjegimete saj, subjekti i rivlerësimit, konfirmon të njëjtin fakt, si dhe bashkëlidhur vendim gjyqësor, nr. ***, datë 09.11.2017, i cili i përket gjyqtarit J. H. dhe gjyqtares R. M.

Në përfundim, lidhur me këtë denoncim, Komisioni, vëren se nuk ka fakte apo rrethana që lidhen me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

²¹Për qëllime të këtij Raporti, sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 07.05.2018. Denoncuese znj. E. D.**

2.1 Denoncuesja, znj. E. D., ka pretenduar që është zhvilluar një gjyq penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujës, në ngarkim të saj, si dhe pretendon se nuk ishte vënë në dijeni nga kjo gjykatë dhe gjyqi ishte zhvilluar në mungesë të saj. Në përfundim të gjykimit, denoncuesja ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë për veprën penale të mashtrimit. Denoncuesja ngre pretendimin se nuk ishte respektuar ligji procedural penal për njoftimin e saj për kryerjen e procesit gjyqësor në ngarkim të saj, si dhe ka qenë një proces jo i rregullt ligjor. Në denoncimin e paraqitur nuk ka të depozituar prova për të mbështetur pretendimet e saj.

2.2 KLD-ja, në përgjigjen e saj, pas shqyrtimit të dosjes përkatëse ka argumentuar se: “Nga procesverbali gjyqësor i çështjes në formatin letër rezulton se ankuesja E. D. në cilësinë e kërkueses ka qenë e pranishme personalisht vetëm në seancën e parë gjyqësore, më datë 10.04.2018, dhe prokurori si person i interesuar. Ndërsa në seancat e tjera kërkuesja ishte përfaqësuar nga avokatët. Nga dëgjimi i seancave në formatin CD rezulton se në seancën e fundit gjyqësore të datës 02.05.2018 nga gjyqtarja Alma Kolgjoka ishte ndërhyrë ndaj një personi të pranishëm në sallë me fjalët: “*ulu, ulu, s’ke të drejtë, të kam thënë i dëmtuari nuk legjitimohet si palë në proces, rri si dëgjues*”. Në këto rrethana, nuk rezultonte që gjyqtarja Alma Kolgjoka të ketë shfaqur sjellje të njëanshme dhe jo dinjitoze ndaj pjesëmarrësve në gjykim, pra, nuk provohet që në këtë rast gjyqtarja të kishte kryer shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

2.3 Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera²² në shpjegimet e saj, ka argumentuar se vendimi nr. *** Akti, datë 02.05.2018, sipas të cilit ishte vendosur refuzimi i kërkesës penale nr. *** Akti, me kërkuese E. D., me objekt: “Rivendosje në afat të së drejtës së apelimit ndaj vendimit nr. ***, datë 12.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”, rezulton se ky vendim është konsideruar i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 04.06.2018, ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga ana e saj, si dhe ndaj këtij vendimi nuk është bërë rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë.

Në përfundim, mbi këtë denoncim, Komisioni vëren se, nga analizimi i dosjes, raportit të KLD, lidhur me pretendimin e denoncueses për zhvillimin e gjykimit në mungesë të saj, rezulton se denoncuesja fillimisht kishte qenë e pranishme personalisht dhe me pas ishte përfaqësuar me avokatë, duke rrëzuar në këtë mënyrë pretendimin e denoncueses për zhvillimin e gjykimit në mungesë, ndërkohë vlerëson se nuk ka fakte dhe prova që të mbështesin pretendimin e saj për një proces jo të rregullt ligjor.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 17.07.2018. Denoncues, z. Xh. C.**

3.1 Denoncuesi, z. Xh. C., ka pretenduar se ka pasur zvarritje të gjykimit administrativo-penal dhe se subjekti i rivlerësimit kishte shtyrë pa fund gjykimin duke pranuar çdo kërkesë të pambështetur në ligj të personit tjetër të interesuar. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar në mënyrë të hapur palën tjetër. Në lidhje me këto pretendime denoncuesi nuk ka paraqitur prova mbështetëse për pretendimet e tij.

3.2 KLD-ja, pas shqyrtimit të dosjes përkatëse ka argumentuar se: “Lidhur me pretendimin e shtetasit Xh. C. se gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. Alma Kolgjoka, për zvarritjen e gjykimit, pas shqyrtimit të akteve të paraqitura rezultoi se gjykimi ka përfunduar për 5 muaj e 8 ditë nga data e shortit 09.02.2017. Afati i gjykimit të çështjeve administrative penale, është përcaktuar në pikën 5 germa “j” të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-

²²Refero shpjegimet e subjektit pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, datë 11.12.2018.

së, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, ku parashikohet se: “Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj”. Në këtë rast ka kapërcim të afatit 2 muaj të përcaktuar për këto lloj gjykimesh nga KLD-ja. Janë caktuar 14 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 4 seanca kanë qenë produktive. Seancat janë caktuar me distancë rreth jo më larg se 15 ditë nga njëra-tjetra në përputhje me nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha seancat gjyqësore janë dokumentuar me regjistrim audio në respektim të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. **3.3** Në analizim, të konstatimeve të KLD-së, lidhur me kalimin e këtij afati, trupi gjykues vëren se të gjitha rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, kanë shkaqe ligjore të dokumentuara. Vetëm në një rast seanca gjyqësore nuk është zhvilluar për mosformim të trupit gjykues nga anëtarja e trupit gjykues E. T.

Në përfundim, lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues konstaton gjithashtu se denoncuesi nuk ka paraqitur prova mbështetëse mbi pretendimet e tij, për favorizim në mënyrë të hapur të palës tjetër.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 09.11.2018. Denoncues, z. P. A.**

4.1 Denoncuesi, z. P. A., ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë një vendim skandaloz dhe aspak profesional sepse nuk kishte zgjidhur problemin e çështjes së tij në lidhje me një ndërtim pa leje në pronën e tij. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi rezulton vendimi gjyqësor nr. ***, datë 16.03.2015, me të pandehur z. S. Z., i akuzuar për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/2, i Kodit Penal, vendim i cili është marrë nga subjekti i rivlerësimit. Nga vendimi gjyqësor rezulton se Prokurori ka kërkuar:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale: “Ndërtimi të paligjshëm” dhe dënimin e tij me dy vjet burgim, aplikimin e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale për gjykim të shkurtuar;*
- *Prishjen e objektit mur rrethues, avlli, me gjatësi 20 m dhe objektin garazh;*
- *Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe shpenzime gjyqësore në ngarkim të të pandehurit.*

Gjykata, pas shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit S. Z. për kryerjen e veprës penale: “Ndërtimi të paligjshëm” dhe dënimin e tij me 12 muaj burg;*
- *Në aplikim të gjykimit të shkurtuar, i pandehuri dënohet me 8 muaj burgim.*

Sipas dokumenteve të depozituar nga denoncuesi rezulton se ky vendim nuk është ankimuar dhe për pasojë ka marrë formë të prerë.

4.2 Në shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, ky vendim rezulton se ka marrë formë të prerë, më datë 26.03.2015, pasi nuk është ankimuar nga asnjëra prej palëve. Për sa i përket aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, ka sqaruar se ka qenë në përputhje me kërkesat e pasqyruara në këtë nen dhe masën e dënimit të parashikuar për këtë veprë penale. Kjo vendimmarrje e gjykatës ishte konsideruar e drejtë edhe nga ana e prokurorit, duke mos bërë ankim ndaj këtij vendimi. Në lidhje me kërkimin civil të prokurorit për të prishur objektin mur rrethues, avlli, me gjatësi 20 m, nuk ishte pranuar nga gjykata, pasi është konsideruar një kërkim i pambështetur në ligj. Sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykata bashkë me dënimin kryesor, kur të dënuarin e ve në provë, mund ta detyrojë të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të parashikuara shprehimisht në nenin 60 të Kodit Penal. Këto janë detyrime plotësuese, të cilat janë parashikuar në mënyrë shteruese, dhe gjykata nuk mund të japë detyrime të tjera, jashtë këtyre parashikimeve. Kërkitimi i prokurorit për të prishur murin rrethues avlli dhe objektin garazh, nuk është parashikuar në asnjë nga detyrimet plotësuese të cituara shprehimisht në nenin 60 të Kodit Penal. Në këto kushte, gjykata nuk mund të pranonte kërkesën e prokurorit për të aplikuar një detyrim plotësues, që nuk rezulton e parashikuar shprehimisht në ligj. Gjithashtu ka sqaruar se ky kërkim mund të vendoset vetëm në përfundim

të një gjykimi civil, ku gjykata pasi të njihet me pretendimet dhe provat e të dyja palëve dhe të realizojë një akt ekspertimi teknik, mund të vendos konform ligjit.

Në përfundim, lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues, pas verifikimit të dosjes pretendimeve të denoncuesit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit vëren se nuk ka fakte dhe rrethana që mund të mbështesin pretendimin e tij. Në këtë drejtim trupi gjykues, ka në konsideratë dhe faktin e mos ushtrimit nga ana e denoncuesit edhe te mjeteve ligjore të apelimit që i njeh ligji.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 15.11.2018. Denoncues, z. M. G.**

5.1 Denoncuesi ka pretenduar se nga ana e subjektit të rivlerësimit është marrë një vendim në kundërshtim me provat, sepse ka favorizuar palën tjetër kundërshtare. Denoncuesi ka bashkëlidhur denoncimit dhe një CD audio, të një emisioni investigimi që ka trajtuar çështjen e denoncuesit.

5.2 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të gabuar kishte cituar në vendim lejen e ndërtimit nr. ***, datë 18.11.2009, marrë nga KKRT-ja (Bashkia Krujë) si të ishte leje e ndërtimit lëshuar për shoqërinë “***” sh.p.k., ndërkohë që nga verifikimi i CD audios rezultoi që kjo leje ndërtimi ishte lëshuar në emër të z. M. G., si dhe vendimi i subjektit të rivlerësimit ishte ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila e kishte prishur vendimin e subjektit të rivlerësimit duke e kthyer për rigjykim me një tjetër trup gjykues.

5.3 Në shpjegimet e saj subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka argumentuar se rezultonte e vërtetë se Gjykata e Apelit Tiranë, ka prishur vendimin e saj, duke e kthyer çështjen për rigjykim, por prishja e këtij vendimi nuk kishte ardhur për shkak të mosrespektimit të procedurës, por nga analiza e provave nga trupi gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke i dhënë një interpretim të ndryshëm dhe për pasojë duke ju krijuar një bindje e brendshme, e ndryshme nga subjekti. Arsyetimi i saj mbi rrëzimin e padisë së paditësit M. G., i ka pasqyruar shprehimisht në vendim, gjatë të cilit ishte realizuar dhe një akt ekspertimi teknik nga eksperti A. LL., i cili ka arritur në konkluzionin se pretendimet e paditësit M. G. nuk qëndronin, referuar edhe VKM-së nr. 502., date 13.07.2011, ndryshuar me VKM-në nr. 314, date 13.03.2013.

5.4 Një argument që rrëzon pretendimet e ankuesit M. G., ishte se vendimi²³ nr. ***, datë 22.09.2014, dhënë nga ana e saj, si i padrejtë, lidhet me faktin se edhe në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë (*konkretisht gjyqtare E. T.*) ka vendosur përsëri “Rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit M. G., si të pambështetur në prova dhe në ligj”.

5.5 Lidhur me këtë denoncim trupi gjykues, konstaton se pretendimet e denoncuesit janë të lidhura me themelin e çështjes, e cila vendoset përmes shkallëve të tjera të gjykimit.

Në përfundim lidhur me denoncimet trupi gjykues, ka konstatuar se denoncimet e paraqitura, nuk përmbajnë fakte apo rrethana që lidhen me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

²³1-Vendim nr. ***, datë 22.09.2014, dhënë nga ana ime, me shënimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë.

2-Vërtetim nr. *** prot., datë 11.12.2018, lëshuar nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, dhe referuar nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, me funksion gjyqtare dhe kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 17.12.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Suela ZHEGU
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro